

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Tërhiqet Bekim Sejdiu, dështon kandidatura për President: Nuk ka mbështetje të mjaftueshme parlamentare
ADRESA	https://kohajone.com/lajme/terhiqet-bekim-sejdiu-deshton-kandidatura-per-president-nuk-k-a-mbeshtetje-te-mjaftueshme-parlamentare/
BURIMI	kohajone.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	14 shtator 2026, 17:19:37 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	14 shtator 2026, 17:18:38 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	8a77ad4a83169927230748b3f0469d0cabf573ba34c7c9bd096ab96dc741d746
TEKSTI	c37b420fceca23dbdfae19df77dfae5fa9488a4055b965755ea76ae5c7d78bd7
PAMJA	d04a412cb0959a7ac0401e0f03fb158b1d1b424ebceb45351748120a7226914d

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	b979d8fcf3618c0d7c47cab22e94ed11468d883571264d5ad2d3f14c89876e34
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	7b2b016d700840f0d00306452beff4854c87a5a9cfd79fec123f45a77e434d02
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërin nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahase hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/b979d8fcf3618c0d7c47cab22e94ed11468d883571264d5ad2d3f14c89876e34>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px


Tërhiqet Bekim Sejdiu, dështon kandidatura për President: Nuk ka mbështetje të mjaftueshme parlamentare

AKTUALITET KRYESORE E HËNË, 14 SHTATOR 2026 19:18



Bekim Sejdiu ka njoftuar tërheqjen nga kandidatura për president të Kosovës, duke thënë se vendimi erdhi për shkak të mungesës së mbështetjes së nevojshme në Kuvend dhe përplasjeve politike rreth procesit. Sejdiu ka treguar se para dy javësh ishte kontaktuar nga përfaqësues të LDK-së dhe ishte ftuar në një takim me delegacionet e LDK-së dhe LVV-së. Sipas tij, në takim ishte bërë e ditur se të dyja partitë kishin arritur marrëveshje që ai të propozohej si kandidat jopartiak për president. Ai tha se e kishte pranuar kandidaturën për shkak të krizës institucionale dhe me synimin për të ndihmuar në zhblokimin e situatës politike. Sejdiu ka bërë të ditur se për vendimin i kishte njoftuar paraprakisht përfaqësuesit e LDK-së dhe LVV-së. Ai ka falënderuar të gjithë ata që e mbështetën kandidaturën e tij, veçanërisht përfaqësuesit e shoqërisë civile dhe mërgatën shqiptare në SHBA.

Postimi i plotë



Të dashur qytetarë të Republikës së Kosovës, të dashur miq! Para dy javësh u kontaktova nga përfaqësues të Lidhjes Demokratike të Kosovës, nga të cilët u ftova në një takim të përbashkët me delegacionet e kryesura nga liderët e Lidhjes Demokratike të Kosovës dhe të Lëvizjes Vetëvendosje. Aty u njoftova se, pas një procesi shterues bisedimesh, këto dy parti kanë arritur pajtueshmëri që emri im të propozohet si kandidat jopartiak për President të Republikës së Kosovës. E konsideroj këtë si besim të madh ndaj meje si person dhe një vlerësim për kontributin tim në jetën institucionale të Republikës së Kosovës.

Përfaqësuesve të këtyre dy partive ua shpreh mirënjohjen time më të thellë, që më kanë nderuar me një besim të tillë dhe për mbështetjen e tyre përgjatë këtij procesi. Duke qenë i vetëdijshëm për periudhën e vështirë nëpër të cilën po kalon vendi ynë dhe për rrezikun që kriza institucionale të thellohet, kam pranuar të jem kandidat për President të Republikës së Kosovës.

LAJMET KRYESORE



Saida Dollani, gjyqtarja që guxoi të vendosë një standard drejtësie



Mos i përdorni fëmijët e shkollave për mitingje dhe luftë politike!



Trump kundërshton rregullimin e AI, sulmon CEO-n e Anthropic, Dario Amodei



OKB bën thirrje për 'veprim urgjent' për të frenuar AI përballë 'rreziqeve të paprecedenta'



Zv/kryeministria Koçi për alarmin e rremë në shkollë: Çmenduri e mirëfilltë kriminale

TË PËRZGJEDHURA



Edmond Spaho te Nikoll Lesi: PD ka mbaruar, nuk vjen ne pushtet!



Luka Modric konfirmon pjesëmarrjen me Kroacinë në Ligën e Kombeve



Dëshirat e Spallettit dhe blerjet e Juventus-it



Tesla, drejtimi gjysmë-autonom drejt përshtatjes me rregullat evropiane, thotë Franca



Shpërthen Erion Braçe te Nikoll Lesi në KOHA JONË-DEBAT: Nuk votoj kandidat me "njoftim"!

MË TË LEXUARAT

Komoditetin personal dhe indiferencën intelektuale nuk i kam konsideruar asnjëherë opsione kundruall nevojës për t'i shërbyer vendit, sidomos në situata krizash. I kam qëndruar gjithmonë idesë se intelektualët dhe profesionistët kanë përgjegjësi ndaj shoqërisë dhe se kapacitetet intelektuale dhe aftësitë e tyre profesionale nuk kanë asnjë vlerë nëse nuk vihen në shërbim të interesit të përgjithshëm.

Siç e kam thënë edhe në paraqitjen time publike, nuk kam pasur asnjë ambicie për pozita publike përtej atyre akademike dhe profesionale dhe motivi im i parë dhe i vetëm për ta pranuar propozimin për postin e Presidentit të shtetit ka qenë që të vihem në shërbim të zhblokimit të ngërçit institucional. Kam besuar se partitë politike parlamentare dhe deputetët e Kuvendit të Republikës së Kosovës do të gjejnë forcë për t'i tejkaluar ndasitë politike ose çfarëdo interesi tjetër, për t'i dhënë vendit institucione stabile në këto kohë të vështira dhe me plot sfida.

Në rrethanat e krijuara, të karakterizuara nga mungesa e mbështetjes së nevojshme parlamentare për zgjedhjen time si Presidentit dhe nga devijimi i tërë procesit në vorbullën e dinamikave dhe përplasjeve të brendshme politike, kam vendosur të tërhiqem nga kandidatura për President të Republikës së Kosovës.

Për këtë vendim timin i kam njoftuar më herët përfaqësuesit e Lidhjes Demokratike të Kosovës dhe të Lëvizjes Vetëvendosje. Mbështetja e gjerë që më është ofruar këto ditë, nga kolegë, miq, personalitete publike e të shoqërisë civile dhe, në mënyrë të veçantë, nga mërgata shqiptare në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, më ka bërë krenar për punën time në shërbim të Republikës së Kosovës.

Kjo ma përforcon besimin e patundur se lojalitetin institucional dhe patriotizmin kushtetues i kam pasur gjithmonë si udhërrëfyesit e vetëm në angazhimin tim institucional. Atë përcaktim, sidomos në mbrojtje të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, asnjëherë nuk e kam pasur selektiv apo konjunktural, por parimor dhe profesional.

Republika e Kosovës dhe qytetarët e saj nuk kanë nevojë për drama politike dhe thellim të polarizimit, por për maturi dhe bashkim në funksion të forcimit të shtetit tonë. Prandaj, me sinjeritetin më të madh shpresoj se partitë politike do të gjejnë rrugëdalje nga ky rreth vicioz, i cili, më shumë se çdo gjë tjetër, po e venitë shpresën e qytetarëve për një të ardhme prosperuese për ta dhe familjet e tyre. Republika e Kosovës është shtëpia jonë e përbashkët, e lindur nga ideale të pathyeshme dhe sakrificë sublime. Kosova qëndron mbi çdonjërin prej nesh, ndaj, së bashku, ia kemi borxh t'i shërbejmë me devotshmëri, gjithmonë, kurdo dhe pa asnjë kusht.

Sinjerisht, Bekim Sejdiu

ETIKETA BEKIM SEJDIU

MË SHUMË NGJA AKTUALITETI




Shqipëri-Kroaci, të rinjtë bashkojnë vizionin për Evropën



Ministri Jaupaj: Investitorët sauditë, interes për energjinë e rinovu...



Mazhoranca kërkon rritjen e pagave të gjyqtarëve, Bylykbashi: Brenda ...



Saida Dollani, gjyqtarja që guxoi të vendosë një standard drejtësie




SHBA-Shqipëri, trajnim për misionet e evakuimit mjekësor me helikopte...



Zv/kryeministrja Koçiu për alarmin e rremë në shkollë: Çmenduri e mir...

LAJMET E FUNDIT





Zgjedhjet lokale 2027/ Partia Mundësia mbledh strukturat, Shehaj: Do të jemi në çdo Këshill Bashkiak

[14 MINUTA MË PARË](#)



Shqipëri-Kroaci, të rinjtë bashkojnë vizionin për Evropën

[19 MINUTA MË PARË](#)



Ministri Jaupaj: Investitorët sauditë, interes për energjinë e rinovueshme dhe turizmin e qëndrueshëm në Shqipëri

[38 MINUTA MË PARË](#)



Prefekti i Tiranës, Shkëlqim Hajdari uron nisjen e vitit të ri shkollor: E ardhmja e Shqipërisë fillon në bankat tuaja

[48 MINUTA MË PARË](#)



16 shtatori, ambasada e Amerikës thirrje qytetarëve: Mos shkoni në punë, as shkolla

[55 MINUTA MË PARË](#)



Mazhoranca kërkon rritjen e pagave të gjyqtarëve, Bylykbashi: Brenda kufijve kushtetues

[1 ORË E 1 MINUTË MË PARË](#)

MË SHUMË LAJME TË FUNDIT >

Gazeta "KOHA JONË" themeluar si e pavarur më datë 11 Maj 1991

Botues: **Nikoll LESI**. Adresa e redaksisë: Rruga "Samë Frasheri", Pallatet e Aviacionit të Vjetër Nr. 2, TIRANA - ALBANIA

TË FUNDIT

LAJME

SPORTI

EKONOMI

EDITORIAL

WEBTV

AKTUALITET

RAJONI

KOSOVA

BOTA

TEKNOLOGJI

SHOWBIZ

SHËNDETI

SOCIALE

TURIZËM

KURIOZITETE

KULTURA

HISTORIKU

KONTAKT

BOTUES & DREJTOR: Nikoll LESI

KRYEREDAKTOR: Daniel MUÇAKU

ZV/KRYEREDAKTOR: Redjon SHTYLLA

BORDI: Elsa KAMBERI, KRYETARE

NIPT: J71425013C



NDËRTUAR DHE MIRËMBAHET NGA



© 2024 KOHA JONË. All rights reserved.

[PRIVACY POLICY](#)

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.